

Çfarë duhet të dini kur ju përshkruhet një antibiotik

What You Need to Know When You Are Prescribed an Antibiotic(Albanian)

Ekipi i kujdesit shëndetësor ju ka përshkruar antibiotikë pasi mendon se mund të keni një infeksion ose një gjendje tjetër mjekësore për të cilën nevojiten antibiotikë. **Antibiotikët** janë barna të fuqishme që eliminojnë bakteret dhe mund të shpëtojnë jetë. Disa infeksione mund të trajtohen me antibiotikë. Si të gjitha barnat e tjera, antibiotikët kanë efekte anësore dhe duhet të përdoren vetëm kur është e nevojshme. Mjeku juaj mendon se në këtë moment përfitimet nga antibiotikët janë më të mëdha se rreziqet.

Your healthcare team has prescribed antibiotics for you because they think you may have an infection or another condition which requires antibiotics.

Antibiotics are powerful medications that kill bacteria and can save lives. Some infections can be treated with antibiotics. Like all medications, antibiotics have side effects and should only be used when necessary. Your doctor thinks the benefits of antibiotics are greater than the possible risks at this time.

Cilat janë disa pyetje rreth antibiotikëve që mund t'ia bëj mjekut tim?

What are some questions to ask my doctor about antibiotics?

Si pacient ose kujdestar, është e rëndësishme të kuptoni trajtimin tuaj ose trajtimin e të afërmit tuaj me antibiotikë. Ja disa pyetje të rëndësishme që mund t'ia bëni ekipit të kujdesit shëndetësor nëse nuk e ka diskutuar këtë me ju më parë:

As a patient or caregiver, it is important to understand your or your loved one's antibiotic treatment. Here are some important questions to ask your healthcare team if they haven't already talked about this with you:

- Çfarë infeksioni ose gjendjeje mjekësore trajton ky antibiotik dhe nga e dini që e kam atë infeksion ose gjendje mjekësore?

What infection or condition is this antibiotic treating, and how do you know I have that infection or condition?

- Cilat efekte anësore mund të shfaqen për shkak të këtij antibiotiku?

What side effects might occur from this antibiotic?

- Sa kohë do të duhet ta marr këtë antibiotik?

How long will I need to take this antibiotic?

- A është e sigurt ta marr këtë antibiotik bashkë me barna të tjera ose suplemente (si vitaminat) që jam duke marrë?

Is it safe to take this antibiotic with other medications or supplements (like vitamins) that I am taking?

- A ka ndonjë udhëzim të veçantë që duhet ta di rreth marrjes së këtij antibiotiku? Për shembull, a duhet ta marr bashkë me ushqimin?

Are there any special directions I need to know about taking this antibiotic? For example, should I take it with food?

- Si do të monitorohem për ta ditur nëse infeksioni ose gjendja ime mjekësore po reagon ndaj antibiotikut?

How will I be monitored to know whether my infection or condition is responding to the antibiotic?

A do të kem efekte anësore nga antibiotiku?

Will I have side effects from my antibiotic?

Mundet të keni. Një nga efektet anësore më të zakonshme të pothuajse të gjithë antibiotikëve është diarreja. Zakonisht kjo nuk është e rëndë, por ndonjëherë diarreja mund të shkaktohet nga një bakter i quajtur *Clostridium difficile* (*C. difficile*, ose "*C. diff*"). Kjo ndodh për shkak se antibiotikët shkatërrojnë disa nga bakteret normale, të dobishme në zorrë. Kjo lejon mbizotërimin e bakterit *C. difficile* dhe i vë pacientët në rrezik të lartë për këtë infeksion të rëndë.

You might. One of the most common side effects of nearly all antibiotics is diarrhea. Usually this is not severe, but occasionally diarrhea can be caused by a bacteria called *Clostridium difficile* (*C. difficile*, or "*C. diff*"). This happens

because antibiotics destroy some of the normal, helpful bacteria in your gut. This may allow the *C. difficile* bacteria to take over, and it puts patients at high risk for this serious infection.

Një efekt tjetër anësor i antibiotikëve është reaksioni alergjik. Shpërthimi në lëkurë është shumë i zakonshëm, por disa reaksione mund të jenë edhe më të rënda. Megjithatë, jo të gjitha shpërthimet në lëkurë janë alergji, prandaj është e rëndësishme të flisni me mjekun tuaj nëse keni një shpërthim në lëkurë. Reaksionet më të rënda alergjike përfshijnë urtikariet (njolla të kuqe e të ënjtura që kruhen), ënjtjen e buzëve, gjuhës ose fytit, gulçime ose vështirësi në frymëmarrje, ose të vjella.

Another common side effect of antibiotics is an allergic reaction. A rash is most common, but some reactions can be more serious. Not all rashes are allergies, though, so it is important to talk with your doctor if you get a rash. The most serious allergic reactions include hives (itchy red patches with swelling), lip, tongue, or throat swelling, wheezing or difficulty breathing, or vomiting.

Kur duhet ta telefonoj mjekun tim?

When should I call my doctor?

Në shumicën e rasteve diarreja e shkaktuar nga antibiotikët nuk është infektive dhe nuk duhet të shkaktojë shqetësim. Duhet **ta njoftoni menjëherë ekipin e kujdesit shëndetësor nëse keni jashtëqitje të ujshme (fece) 3 ose më shumë herë në ditë** gjatë marrjes së një antibiotiku, pasi kjo mund të jetë shenjë e një infeksioni me *C. difficile*. Diarreja e shkaktuar nga *C. difficile* mund të jetë e rëndë dhe duhet të trajtohet menjëherë. Rreziku i prekjes nga diarreja e *C. difficile* është më e lartë gjatë muajit të parë, por mund të zgjasë deri në 3 muaj pasi e ndërpritni marrjen e antibiotikëve. Njoftoni ekipin e kujdesit shëndetësor nëse keni diarre edhe pasi e ndërpritni marrjen e një antibiotiku.

Most diarrhea caused by antibiotics is not infectious and should not cause concern. You should **let your healthcare team know right away if you develop watery stool (poop) 3 times or more per day** while taking an

antibiotic, because that may be a sign of a *C. difficile* infection. Diarrhea caused by *C. difficile* can be serious and it must be treated quickly. The risk of getting *C. difficile* diarrhea is highest during the first month, but it can last for up to 3 months after you stop taking antibiotics. Let your healthcare team know if you develop diarrhea even after you stop taking an antibiotic.

Telefononi mjekun nëse ju shfaqet një shpërthim në lëkurë ose një shenjë tjetër e një reaksioni alergjik gjatë marrjes së një antibiotiku.

Call your doctor if you develop a rash or another sign of an allergic reaction while taking an antibiotic.

Telefononi në numrin 911 për të marrë ndihmë të menjëhershme nëse:

Call 911 to get help immediately if:

- Keni ënjtje të buzëve, gjuhës ose fytit
You develop lip, tongue, or throat swelling
- Keni gulçime ose vështirësi në frymëmarrje
You are wheezing or have difficulty breathing

Mos harroni, antibiotikët janë barna që shpëtojnë jetë dhe duhet të përdoren siç duhet. Është e rëndësishme t'i merrni antibiotikët me saktësi siç janë përshkruar. Nëse keni ndonjë pyetje rreth antibiotikëve, flisni me ekipin e kujdesit shëndetësor.

Remember, antibiotics are life-saving drugs and they need to be used properly. It is important to take your antibiotics exactly as prescribed. If you have any questions about your antibiotics, please talk with your healthcare team.

Deklarata e mohimit të përgjegjësisë: Ky dokument përmban informacion dhe/ose materiale udhëzuese të zhvilluara nga University of Michigan (U-M) Health për pacientin tipik me gjendjen tuaj. Ai mund të përmbajë lidhje për përmbajtje në internet që nuk janë krijuar nga U-M Health dhe për të cilat U-M Health nuk mban përgjegjësi. Ai nuk zëvendëson këshillat mjekësore nga ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor, pasi përvoja juaj mund të ndryshojë nga ajo e pacientit tipik.

Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse keni pyetje në lidhje me këtë dokument, gjendjen tuaj ose planin tuaj të trajtimit.

Disclaimer: This document contains information and/or instructional materials developed by University of Michigan (U-M) Health for the typical patient with your condition. It may include links to online content that was not created by U-M Health and for which U-M Health does not assume responsibility. It does not replace medical advice from your health care provider because your experience may differ from that of the typical patient. Talk to your health care provider if you have any questions about this document, your condition or your treatment plan.

E përshtatur nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Centers for Disease Control and Prevention, CDC). Në spital ju është përshkruar një antibiotik për një infeksion. Hyni në adresën: <https://www.cdc.gov/antibiotic-use/community/pdfs/Inpatient-Fact-Sheet-P.pdf>

Adapted from Centers for Disease Control and Prevention (CDC). You've Been Prescribed an Antibiotic in the Hospital for an Infection. Access at: <https://www.cdc.gov/antibiotic-use/community/pdfs/Inpatient-Fact-Sheet-P.pdf>

Autore: Vanessa Scowden, MD

Author: Vanessa Scowden, MD

Redaktuar nga: Brittany Batell, MPH MSW

Edited by: Brittany Batell, MPH MSW

Ky përkthim u mundësua nga "Friend's Gift Shops".

This translation was made possible by Friend's Gift Shops.

Edukimi i pacientit nga [U-M Health](#) është licencuar nën [Creative Commons Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0 International Public License](#). Rishikimi i fundit më 10.2023

Patient Education by [U-M Health](#) is licensed under a [Creative Commons Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0 International Public License](#). Last Revised 10/2023